



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA OBILIQ - OPATINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC
Nº Dr. Nro. 01-060-01-23076-25
Nr. Dr. Nro. 15.08.2025
Data / Datum / Date
OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Nga mbledhja e Kuvendit komunal të mbajtur me dt. 29.07.2025, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Florije Jashari (IQO), Labinot Mirena (IQO), Vlora Mjekiqi Kabashi, (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Nazlije Shala, (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Valon Svirca (LVV), Lendita Krasniqi (LVV), Albana Shillova Shalaku (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Bajram Hashani (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Ratomir Ristic (SL) dhe Biljana Spasic (SL).

Të pranishmit tjerë: Ibush Mjekiqi, Nënkyrytar Komunës, drejtori komunal, Haki Jashari, drejtore i QKMF-së, Ganimete Aliu, zyrtare për barazi gjinore, përf. e OSBE-së dhe përf. e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cila pasi konstataoi se ka kuorum filloimbledhjen me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara
3. Raporti i shpenzimeve për periudhën Janar – Qershor 2025
4. Raporti i Auditimit për Pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Obiliqit për vitin 2024
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës nga DPUKP-ja, nr. 05-070/05-0006650/25, të dt. 02.07.2025
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës nga DSHMS-ja, nr. 08-104/02-18721/25, e dt. 10.07.2025
7. Dhënia në debat publik e Planit të Veprimit për Persona me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Obiliqit 2026-2029 dhe Strategjinë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara
8. Shqyrtimi i kërkesave
9. Të ndryshme

Kryesuesi – Fillimisht ju njoftoj dhe besoj se edhe ju e keni në emailat e juaja se Demos ka kërkuar që sot në ora 12:00 të jeni në një punëtori ju si anëtarë të Kuvendit bashkë me anëtarët e Fushë Kosovës, në restorantin Sonoma ku atje e keni edhe drekën.

Pastaj kryesuesja i njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 17 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Mungoi: Linda Sadiku Krasniqi

Pika 2 e rendit të ditës

Sami Ahmeti – Te pika 6 e procesverbalit janë 2 gabime, te pjesa e fjalimit tim dhe njëri është në vend të “siç kam thënë në javën e kaluar” duhet të jetë “në muajin e kaluar”. Tjetra, është sigurisht gabim teknik shkruan “kërkesë mirrore” që nuk është fjalë e imja, kështu që këto të përmirësohen.

Kryesuesja – Sa i përket fjalës mirrore në diskutim ashtu e kemi dëgjuar dhe nuk e kuptuam, por kjo do të përmirësohet.

Sami Ahmeti - Mundet me qenë minore, e jo mirrore.

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 18 vota për me ndryshimet dhe plotësimet e cekura më lartë.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti Raportin e shpenzimeve për periudhën Janar - Qershori 2025.

Enver Gashi – Ne si grup nuk kemi vërejtje, por e mirëpresim këtë raport dhe është një raport i rregulltë dhe me kohë.

Sami Ahmeti – Edhe pse për neve ky raport ka mangësi dhe paqartësi të shumta, brendia e tij tregon se brenda kësaj kohe është bërë shumë pak për qytetarët e Obiliqit. Ende vazhdon që pjesa kryesore e buxhetit të shkon në kogjenerim edhe pse kontrata për këtë projekt nuk është transparente. Te investimet kapitale është një rresht që shkruan bashkëfinancim 150,000 €, prej të cilave 139,000 €, janë shpenzuar ndërsa nuk flet për cilin projekt. Disa rrugë as që kanë filluar, janë lënë për pjesën e dytë, apo pak para zgjedhjeve. Për ndërtimin e parkut “Adem Jashari” këtij emri të madh të kombit është vendosë që të bëhet në lagjet periferike sepse pjesën qëndrore të qytetit e kanë zënë me emra tjerë të mëdhenj. Pra, për ndërtimin e këtij parku keni paraparë 20,000 €, por ende as nuk janë alokuar, as nuk është bërë asgjë. Te subvencionet, kryesisht në bujqësi te kjo shtresë ku qytetarët kanë më së shumti nevojë brenda 6 muajve, sipas këtij raporti keni dhënë 16,363, 50 centë prej të cilave 11,263 €, për vaksionim të kafshëve dhe vetëm 5,100 €, përmirësohet përmirësohet dhe atë vetëm për komunitete. Do të thotë se interesimi juaj në bazë të këtij raporti janë kontratat e mëdha në afate që riparohen çdo vit. Unë e di që raportet nuk votohen, por ky raport tregon punën shumë të dobët të kësaj qeverie.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti Raportin e Auditimit për Pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Obiliqit për vitin 2024.

Enver Gashi – Raporti i auditimit është një raport i rregulltë dhe normal që ku punohet ka edhe të meta, por shumica janë të mira dhe shpresoj e besoj shumë se këto vërejtje do të përmirësohen. Ndërsa, janë edhe në vazhdimësi duke punue prandaj ky raport që është e pranojmë.

Sami Ahmeti – Te ky raport kemi 9 rekomandime, 5 janë të reja, 2 janë të përsëritura dhe 2 tjera, janë pjesërisht të përsëritura. Disa nga këto rekomandime janë dhënë për arsyet e mëposhtme, do të thotë keqklasifikim i qëllimshëm i shpenzimeve, nënvlërësimi i pasurive kapitale në pasqyrat financiare dëshmorësimi i pasurive jokapitale, kuptohet me qëllim të keqpërdorimit të tyre, vonesa në përfundimin e punëve të kontraktuara për shkaktuara nga mosplanifikimi i duhur. Pastaj, raportimi i mangët nga përfituesit në lidhje me subvencionet, që ky rekomandim nxjerrë në pah se subvencionet nuk iu jepen personave adekuat, ato keqpërdoren pastaj nuk mund të dokumentohen. Rekomandimi tjetër është zhvillimi i procedurës së prokurimit në kundërshtim me kërkesat ligjore për kontratat me vlerë të përbashkët rreth një million euro, vonesa në kryerjen e obligimeve të papaguara dhe shpenzimeve gjyqësore përmbarimore me ç'rast në 8 raste buxheti i Komunës është dëmtuar për 266,000 €. Registrat e menaxhimit të kontratave jo përmes platformës eprokurimi, por e dijmë të gjithë për çka bëhet kjo, mosmbyllja e investimeve në vijim, do të thotë edhe pse janë krye ato nuk mbyllen për shkak se tani ka mundësi disa fonde me i përcjellë andej. Mangësi në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme, që për vitin 2014 i ka shkaktue dëme Komunës, apo ulje 387,000 €. Komenti jonë është që këto keqmenaxhime, këto keqpërdorime do të mbarojnë shumë shpejtë. **Zarife Behluli** – E kuptoj shqetësimin e parafolësit, por e qëllimshme është se kontratat kolektive e kanë bërë raportin e modifikuar, e jo keqmenaxhimi i Komunës, as keqklasifikimi i shpenzimeve që janë bërë në

Komunën e Obiliqit, mirëpo shteti është shtet dhe ne duhet me respektue. Do të thotë keqklasifikim rapporti që është i modifikuar është bazuar në kontratatat kolektive, ekzekutimi i mjeteve nga thesari, e kanë edhe raportin 6 mëjor ku janë marrë mjetet për vitin 2025.

Sami Ahmeti – Unë vetëm deshta me thënë se i kam konsiderue si të tilla sepse në përgjegjet që i ka dhënë menaxhmenti i Komunës, në këtë rast nuk ka cekë elemente të tilla siç e tha drejtoresha, por ka cekë se vetëm pajtohem i kemi bërë këtë apo atë shkelje. Nuk është bë në përgjegje me thënë se kjo është bërë për arsy, por kanë thënë se pajtohem i kemi bërë këtë shkelje.

Kryesuesja – Normal që pajtohem i sepse është e drejtë kur vjen plani i veprimit në muajin tjetër edhe sqarohet.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin dhe aprovin e kërkesës nga DPUKP-ja, nr.05-070/05-0006650/25, të dt.02.07.2025.

Enver Gashi – Ne edhe në KPF u dakorduam që të vjen kjo pikë e rendit të ditës në Kuvend. Ne si shprehje e kuptojmë se nuk ka shkelje ligjore dhe jemi për aprovin e kësaj kërkesë.

Sami Ahmeti – Unë nuk e di sa banorë ka ajo rrugë apo ajo lagje. Sido që të jetë nëse, kjo kërkesë është dakordim i këtyre 21 personave edhe pse emrat dhe numrat personal të tyre figurojnë në kërkesë pa nënshkrime nëse, është kërkesa e tyre ne jemi dakord dhe e votojmë pro.

Ajet Berisha – Mendoj se vetëm nëse, kanë ndërruar rregullat se ne nuk mundemi për çdo kërkesë të qytetarëve me plotësue listën. Unë nuk e di në fillim të këtij viti, apo në vitin e kaluar në fund të vitit e kemi plotësue listën e emrave, që bëhet çdo 3 vjet plotësimi i listës në rast se në listën rezervë nuk ka emra të mjaftueshëm edhe dalin rrugë të reja që kanë nevojë me u emërue. Unë fillimisht këtu, i kam dyshimet e mia sepse nuk mundemi çdo kërkesë të qytetarit me iu përgjegjë, por edhe kjo kërkesë e ka afatin kohor. Këto kërkesa, Komuna duhet me i grumbullue dhe kur vjen koha për plotësim të kësaj liste, që është e rregulluar me ligj dhe me rregulla sepse ne e kemi listën rezervë me emra që çdo rrugë e re në bazë të renditjes e merre emrin për të cilin ky Kuvend ka votue. Mendoj se proceduralisht nuk jemi në rregullë hiç për shkak se është një 30 % i rrugëve me emra rezervë që rrijnë dhe nuk ke nevojë çdo kërkesë të qytetarëve, por çdo 3 vjet ke me rishqyrtime se a ke nevojë, apo nuk ke nevojë me i shtue. Do të thotë proceduralisht kjo punë nuk është në rregullë dhe unë nuk marrë pjesë fare në votim.

Arben Berisha – Ju sqaroj se me ligj të vjetër ka qenë emërtimi direkt prej Kuvendit për x rrugën dhe tash kemi të bëjmë me listën që ne nuk kemi të drejtë me emërtue rrugë, por vetëm e krijojmë listën rezervë. Ne kemi folë edhe në seancat e mëhershme, që e kemi aprovuar listën rezervë. Tash, në bazë të kërkesave të banorëve, me propozimin e tyre ne kemi të drejtë nëse, ju e miratoni kjo përfshihet në listën rezervë dhe bëhet plotësim i listës rezervë, e jo emërtim i rrugëve. Banorët tash nëse, dojnë me marrë e zgjedhin x emrin, kështu që z.Ajet me ligj jemi në rregullë, por për çështje të tjera besoj se dosjen e keni të gjithë. Unë e kam sjellë dosjen në bazë të kërkesës së qytetarëve me nënshkime dhe ligji e specifikon edhe historiatin e x personit që ata dojnë me dhënë emrin. Në kuptimin e procedurës dhe mënyrës legislative jemi në rregullë dhe mbetet aprovimi i juaj.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 19 vota për morën Vendim Aprovohet zgjerimi i Listës rezervë me emrin “Zymer Mjeku” i cili emër do të shërbej për emërtimin e rrugës në fshatin Graboc i Epërm, Komuna e Obiliqit.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin dhe aprovin e kërkesës nga DSHMS-ja, nr.08-104/02-18721/25, e dt.10.07.2025

Enver Gashi – Fillimisht them se patjetër duhet ti dalim në ndihmë policëve të Kosovës, edhe pse janë tepër të nënçmuar nga shoqëria jonë. Ky shërbim policor është në gjendje gatishmërie 24 orë, nuk kanë sigurim shëndetësor dhe është e Komunës, së paku që këto shërbime të ua ofrojmë falas.

Sami Ahmeti – E thamë edhe në mbledhjen e KPF-së, se natyrisht që jemi pro por mungojnë dokumentet kërkesat dhe tashmë i kemi të bashkëngjitura. Vetëm te përgjegja e drejtorit, do të thotë jemi shumë pro,

Diue pak po me auket kjo pune sa dunet ne me te per ata. Megjithate, pergjegja e drejtoreit eshte sikur me toje per shtepin e vetë, nuk iu ka bazuar asnjë ligji, sepse kur ka implikime financiare te buxhetit te shtetit, ne duhet me u thirre pak se a eshtë mbajte ndonjëfarë mbledhje, ndonjëfarë Bordi, apo ndonjëfarë menaxhmenti. Ai thotë veç u krye, unë e kryej dhe këto bëhen. Mirëpo, kam frigë se prej këtyre kjo dhe në fund nuk rezulton pozitivisht si vendim i ligjshëm, përndryshe ne jemi pro.

Haki Jashari – Sqaron se kërkesa e stacionit policor të Kosovës, ka rezultue së bashku me drejtoreshën e shërbimit shëndetësor të policisë së Kosovës. Shërbimi i QKUK-së dhe Komuna e Prishtinës i ka lirue pjesëtarët e policisë nga pagesat. Ne mund të ofrojmë falas per pjesëtarët e Policisë së Kosovës të gjitha shërbimet mjekësore dhe diagnostike me përashtim të çeshtjeve administrative siç janë: raportet mjekësore, certifikatat shëndetësore, raporti i pushimit mjekësor si dhe çdo dokument tjetër i kërkuar me kërkesën e palës. Ne e kemi pranuar kërkesën nga Drejtoria e shërbimeve mjekësore të Policisë së Kosovës dhe shprehim gatishmërinë per ta ndihmuar policinë tonë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 19 vota per morën Vendim Aprovohet lrimi nga pagesa e shërbimeve shëndetësore per stafin e Policisë në Komunën e Obiliqit.

Pika 7 e rendit te ditës

Kryesuesja – Paraqiti dhënen në debat publik të Planit të Veprimit per Persona me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Obiliqit 2026-2029 dhe Strategjinë per te drejtat e personave me aftësi te kufizuara.

Enver Gashi – Ne si grup jemi per dhënen në debat publik te këtij plani te veprimit dhe i ftoj anëtarët e Kuvendit si dhe qytetarët që te marrin pjesë sa më shumë e të jatin kontributin e tyre. Gjithsesi, edhe ne pastaj, kur vjen në Kuvend per aprovim do ta jatin kontributin tonë.

Sami Ahmeti – Edhe ne jemi dakord që ky dokument te dalë në debat publik.

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 20 vota per e miratuan Vendimin per dhënen në debat publik të Planit të Veprimit per Persona me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Obiliqit 2026-2029 dhe Strategjinë per te drejtat e personave me aftësi te kufizuara.

Pika 8 e rendit te ditës

Kryesuesja – Ju, bashkë me rekondime keni pranuar një kërkesë nga MAPL-ja, per rishqyrtimin e vendimit te Kuvendit per dhënen në shfrytëzim afatgjatë te pronës së palujtshme te Komunës per 99 vite investitorëve "A Marketing" dhe "Roto Recycling" sepse nuk eshtë në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Ne e kemi diskutuar edhe në KPF, se ky vendim nuk mund te rishqyrtohet per shkak se kemi pranuar një shkresë nga MAPL-ja, bashkë me vendimin në momentin që Presidentja ka shpallë zgjedhjet komunale, ne nuk kemi te drejtë te rishqyrtojmë vendime te tilla. Ky vendim duhet te shfuqizohet

Arben Berisha – Së pari vonesa e kthimit te MAPL-së, ka ndodhë pas 4 ose 5 muajve nëse, nuk gaboj dhe thuhet se ky vendim eshtë në kundërshtim me dispozitat e nenit 11 te Ligjit nr.06-092 per dhënen në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës si dhe me nenin 23 te Regullores. Neni 11 i Ligjit e thotë decedivisht nuk ka asnjë bazë juridike këtë me kundërshtue dhe komplet procedurat qysh i thotë ashtu i kemi krye. E kemi edhe nenin 23 te Regullores, që askund nuk e cekë se ne nuk kemi te drejtë 2 investorë me i përfshi në një parcelë. Ne jemi Komunë numër një në Kosovë që kemi praktikë per dhënen në shfrytëzim te pronës së palujtshme dhe kjo që ka ndodhë me Ministrinë tash, ne te gjithë po e dijmë se çka eshtë duke u bërë. Mirëpo, nuk ka bazë juridike këtë vendim me shfuqizue dhe prej palëve ne e kemi edhe shkresën që na ka ardhë që kanë me i inicue procedurat gjyqësore dhe te fituar e kanë një milion per qind. Edhe per vendimet tjera eshtë folë se janë te paligjshme, pastaj te gjitha kanë ardhë te ligjshme në përpunje me legjsilacionin në fuqi dhe te gjitha janë aprovuar nga MAPL-ja.

Sami Ahmeti – Kjo eshtë shumë e thjeshtë nuk mundesh me i thënë këtë tokë, këtë parcelë, këtë dhomë po ta japë edhe ty edhe ty, ose te paktën me thënë këtë pjesën e poshtme po ta japë ty, këtë pjesën e naltë po ta japë ty. Duhet me u nda këtë e kam kuptue unë këtë përgjegjen, sa e kam pasë e kam pasë moti e këtë përgjegje që eshtë e tillë. Njejtë eshtë edhe per vendimin tjetër që e kemi marrë në muajin e kaluar dhe unë e kam parë përgjegjen që eshtë kthye. Unë nuk e di pse nuk iu ka ardhë juve, por eshtë ardhë përgjegja dhe unë juristë nuk jam, nuk e marrë kompetencën me folë si juristë, por çka do që te keni ata e kanë kthye

vendimin dhe ju kthenu përgjegje atyre, replikoni me ata. Unë e kam njëfarë bindje se gjithçka çka bëhet këtu, bëhet me njëfarë dolloveri dhe unë kam bindje, kam të drejtë me pasë bindje, bile të paktën që vjen prej teje. Shumë mirë që kemi institucion, shumë mirë që kemi Gjykata dhe çka do që keni replikoni atyre, nuk ke nevojë hiç me dalë në foltore me na marrë kohën sepse po e kuptojmë. Kjo është shkelje ligjore se edhe ata nuk guxojnë me kthyje diçka pse iu ka tekë. Është shkelje ligjore dhe si të njejtë e njohim ne si këshilltarë komunal, ti folë sa të duash por në fund aty shkon vendimi

Arben Berisha – Ju sqaroj se komplet vendimin që e kemi bërë është e ndarë 50 % me 50 % është komplet e specifikuar qasja në rrugë dhe të gjithë kemi qenë të kujdeshëm në këtë drejtim. Ministria për të gjitha na ka kërkuar kompletim të dokumentacionit, por për këto dyja nuk na ka kërkuar. Unë dola me sqarue se bazë juridike ka dhe është i plotfuqishëm sipas legjisacionit në fuqi. Vendimi ka ardhë nga Ministria dhe unë jam për me respektue se nuk bën pa e respektue, është shumë e natyrshme, por për opinion duhet me sqarue sepse sa për z.Sami të gjitha kanë qenë të jashtëligjshme mirëpo, të gjitha kanë ardhë të ligjshme. Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 18 vota për e miratuan Vendimin për Shfuqizimin e vendimit nr.01-060-01-13275-25, i dt.19.05.2025 për dhënen në shfrytëzim afatgjatë të Pronës së Paluajtshme të Komunës për 99 vite Investitorëve: "A Marketing & Creators : "SH.P.K. me adresë: Prishtinë-Qyteza Pejton, Rr." Sejdi Kryeziu" Nr.23 dhe "Roto Recycling" SH.P.K. me adresë: Rr."Dr.Shpëtim Robaj" Prishtinë nga 50 % të Njësisë Kadastrale.

Kryesuesja – Paraqiti kërkësen nga Mentor Ramadani për mosinicim të procedurës së shfuqizimit të vendimit nr.01-060-01-13275-25, të dt.16.05.2025. Mirëpo, siç e thashë më heret Kuvendi Komunal është i thirrur që të ndërmerrë masa dhe të veproj sipas ligjeve në fuqi. Unë e potencova që është edhe shkresa e Presidentes dhe Ministrisë, kështu që ne nuk kemi të drejtë ta shkelim ligjin.

Po ashtu, e kemi kërkësen nga MAPL-ja, për rishqyrtim të vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik për Parcelën Kadastrale në Zonën Kadastrale në Plemetin. Ky vendim te preambula është thirrë vetëm në LVL, por jo edhe në Ligjin për shpronësimin e pronave të paluajtshme nr.03/L-139 dhe ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr.03-L-205, të dt.28.10.2010 nenit 72 pika 1.8 e Statutit.

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 12 vota për dhe 5 vota abstenim morën Vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Parcelën Kadastrale në Zonën Kadastrale në Plemetin.

Pika 9 e rendit të ditës

Ajet Berisha – Së paku në bazë të shqetësimeve të njerëzve që përdorin objektin e bibliotekës, thjeshtë të studentëve është për çudi vendimi që keni lëshue ju për ato lojëra që njerëzit e biblioteës nuk kanë kushte minimale. Do të thotë duke mos pasë parasysh absolut nevojën e studentëve, ju i keni vendosë aty me ato vutura, lojëra, muzika në qiel qështu që edhe ata pak studentë që tentojnë me përdorë bibliotekën ua keni pamundësue me këtë vendim që ata me përdorë.

Labinot Mirena – Unë kisha dashtë me ngritë një shqetësim, është mirë me shikue si thotë ligji për me i pasë Komuna e Obiliqit zjarrfikësat e vetë. Është një truall që është ndarë për zjarrfikësa qe disa vite sipas informatave që i kam dhe për shkak të situatës apo gjendjes emergjente që është gati në tërë territorin e Republikës, është mirë me i pasë zjarrfikësat tonë. Me këtë nuk krijohet ndonjë shpenzim, por me rëndësi është se nëse, Komuna ka nevojë për ata me reague shpejtë, ose pak Komunave që i kemi përreth me iu dalë në ndihmë.

Mbledhja përfundoi në ora 11:49'

Bashk.prf.për punë të KK

Azize Zeneli

Kryesuesja e Kuvendit Komunal

Vlora Mjekiqi Kabashi

